

VENDIM
NR. 181, datë 26.2.2020

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2020, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E NEVOJAVE SHITESË PËR SUBVENCION, SI DHE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË SAMITIT DIGJITAL TË BALLKANIT PERËNDIMOR

(Ndryshuar me vendimin nr. 839, datë 28.10.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekësh. Ky fond do të përdoret, si më poshtë:

a) 2 198 840 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të “Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor”, që do të organizohet në Tiranë, në datën 2 nëntor 2020.

b) 41 801 160 (dyzet e një milionë e tetëqind e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për përballimin e nevojave shtesë të vitit 2020.

2. Efekti financiar prej 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për koordinimin e organizimin e këtij samiti dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe